

---

## THE ROLE AND PLACE OF THE PARLIAMENT IN THE POLITICAL SYSTEM OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA: RELATIONS BETWEEN THE LEGISLATIVE POWER AND THE EXECUTIVE POWER

**Lindita Neziri**

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, [lindita.neziri@unt.edu.mk](mailto:lindita.neziri@unt.edu.mk);  
[lindita\\_neziri@outlook.com](mailto:lindita_neziri@outlook.com)

**Abstract:** The parliamentary system is one of the most widespread forms of democratic governance in the world which has been adopted by many states, one of which is the Republic of North Macedonia (hereafter RNM). The political system of the RNM was created with the Constitution of 1991, according to which the RNM is a democratic, independent, and sovereign state. Sovereignty originates from the citizens and belongs to them.

The political system consists of the legislature, the executive, and the judiciary. The separation of powers means their independence, accountability, and mutual control.

The RNM functions according to the parliamentary democracy model.

Parliament is a representative body of citizens and the bearer of legislative power. Parliament is the place where popular sovereignty originates. Its main task is to approve the constitution and laws which are binding for all citizens of the country. In general terms, it can be said that parliament performs three main functions: that of representation, legislation, and control. The organisation and operation of the work of state institutions is regulated by the constitution and special laws.

Executive power is exercised by the President and the Government, however the Government has superiority in exercising the executive function, while the President has more of a ceremonial role and is "under the shadow" of the Government. The Government is elected and controlled by the Parliament, which through a number of tools and mechanisms (vote of no confidence, interpellations, parliamentary investigation) provided by the constitution, and the rules of procedure can shorten its mandate before its expiration. Parliamentary practice is characterised by the functioning of the coalition government.

This study provides a general overview of the Parliament, including its composition and powers; however, the focus is on the relationship and interweaving of the legislative power with the executive power.

This study analyses the political control exercised by the Parliament over the Government, the indirect influence of the President on legislation, and the procedure for legal responsibility of the President initiated by the Parliament.

This study offers recommendations for a more effective and functional governance.

For the needs of the work, descriptive, historical, comparative methods have been used, as well as analysis of positive national legislation.

**Keywords:** North Macedonia, Parliament, President, Government, power.

## ROLI DHE VENDI I KUVENDIT NË SISTEMIN POLITIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT. RAPORTET MES PUSHTETIT LIGJVËNËS DHE PUSHTETIT EKZEKUTIV

**Lindita Neziri**

Universiteti "Nënë Tereza", Republika e Maqedonisë së Veriut, [lindita.neziri@unt.edu.mk](mailto:lindita.neziri@unt.edu.mk);  
[lindita\\_neziri@outlook.com](mailto:lindita_neziri@outlook.com)

**Abstrakt:** Sistemi parlamentar është një nga format më të përhapura të qeverisjes demokratike në botë, të cilin e kanë adoptuar shumë shtete një ndër to edhe Republika e Maqedonisë së Veriut (më tutje RMV).

Sistemi politik i RMV-së u krijua me Kushtetutën e vitit 1991, sipas së cilës RMV është shtet demokratik, i pavarur, e sovran. Sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon atyre.

Sistemi politik përbëhet nga legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori. Ndarja e pushteteve nënkupton pavarshmërinë, përgjegjësinë dhe kontrollin e tyre reciprok.

RMV, funksionon sipas modelit të demokracisë parlamentare.

Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës. Kuvendi është vendi ku buron sovraniteti popullor dhe ka për detyrë të miratojë Kushtetutën dhe ligjet të cilat janë të detyrueshme për të gjithë qytetarët e vendit. Në pika të përgjithshme themi që Kuvendi kryen tre funksione kryesore: atë të përfaqësimit,

legjislativitet dhe kontrollit. Organizimi dhe funksionimi i punës së institucioneve shtetërore rregullohet me Kushtetutë dhe ligje speciale.

Pushetin ekzekutiv e ushtrojnë Presidenti dhe Qeveria, megjithatë Qeveria ka epërsi në ushtrimin e funksionit ekzekutiv kurse Presidenti ka më shumë rol ceremonial dhe është “nën hijen” e Qeverisë (Neziri, 2021: 253). Qeveria zgjedhet dhe kontrollon nga Kuvendi i cili nëpërmjet një numër mjetesh dhe mekanizmash (votë mosbesimit, interpelancave, hetimit parlamentar) të parashikuara me Kushtetutë dhe Rregulloren e punës mund t’ia shkurtoj mandatin para skadimit të tij. Praktika parlamentare karakterizohet me funksionimin e qeverisë së koalicionit.

Punimi ofron pasqyrë të përgjithshme mbi Kuvendin, përfshirë përbërjen dhe kompetencat e ti, megjithatë fokusi është tek raporti mes pushtetit ligjvënës dhe pushtetit ekzekutiv, më konkretisht tek kontrolli politik që ushtron Kuvendi ndaj Qeverisë dhe ndikimin i tërthortë i Presidentit në ligjvënie.

Punimi ofron sugjerime për një qeverisje efektive dhe funksionale.

Për nevojat e punimit përdoren metoda deskriptive, historike, krahasuese, si dhe analizë e legjisacionit nacional pozitiv.

**Fjalë kyce:** Maqedonia e Veriut, Kuvendi, Presidenti, Qeveria, pushteti.

## 1. HYRJE

Elementet konstituive të çdo shteti janë: popullsia, territori dhe pushteti publik (Kuculovska & Sotiroska & Grnçarevsk, 2022:38). Territori shtetëror nënkupton sipërfaqen tokësore deri ku shteti ushtron pushtetin e tij. Shtetet kufizohen me shtete tjera me të cilat ndahet përmes kufijve të jashtëm që përcaktohen në përputhje me të drejtën nacionale dhe ndërkombëtare dhe nuk mund të ndryshohen me dëshirën e shtetit. Për funksionim më efikas, territori i brendshëm ndahet në të ashtuquajturat njësi territoriale (komuna). Popullsia përfshin shtetasit dhe të huajt që jetojnë në territorin shtetëror, gëzojnë të drejta por kanë edhe obligime të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje speciale. Veçori dalluese e shtetit është pushteti publik. Pushteti publik nënkupton marrëdhënie shoqërore ndërmjet dy palëve nga të cilat njëra palë ka të drejtë të jep urdhëra, dhe pala tjetër (e varur) zbaton urdhrat. Pushteti shtetëror është pushteti më i lartë, i pakufizuar, i pavarur, i pandarë, që përfshin gjithçka. Pushteti shtetëror ndahet në pushtet ligjvënës (që e ushtron Kuvendi), ekzekutiv (që e ushtron Qeveria dhe Presidenti) dhe gjyqësor (që e ushtrojnë Gjykatat). Ndarja e pushteteve nënkupton pavarshmërinë, përgjegjësinë dhe kontrollin e tyre reciprok.

Pyetja e hulumtimit është: *Cili është roli i Kuvendit dhe si janë raportet mes pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv?*

Hipoteza e hulumtimit është: *Raportet që krijohen mes aktorëve që përbëjnë sistemin politik të vendit kanë rëndësi të veçantë për funksionimin e sistemit politik.*

## 2. PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT E KUVENDIT NË RMV

Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve, është bartës i pushtetit ligjvënës, është vendi ku diskutohen, debatohet dhe votohet për të marr vendime në interes të përgjithshëm.

Kuvendi përbëhet nga deputetët si përfaqësues të qytetarëve. Deputetët legjitimitetin e fitojnë në zgjedhje nga vullneti i qytetarëve. Mënyra, kushtet dhe procedura për zgjedhjen e deputetëve rregullohen me Kushtetutë, Ligjin për deputet, Rregulloren e punës së Kuvendit, Kodin Zgjedhor të vitit 2006. Korniza ligjore përfshin edhe: Kodin Penal të vitit 1996, Ligjin për partitë politike të vitit 2004, udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve etj. (Neziri, 2022: 17-21).

Sipa Kodit Zgjedhor, kandidat për deputet, mund të jetë çdo shtetas i RMV-së që: ka 18 vjet, është i aftë për punë dhe nuk ka aktvendim gjyqësor për kryerje të ndonjë veprë penale që dënohet me burg me kohëzgjatje prej së paku 6 muajsh (neni 7). Në Kuvend aktualisht janë 123 deputet. Ata gjidhen sipas modelit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura. Territori i shtetit ndahet në gjashtë njësi zgjedhore dhe në çdo njësi zgjedhore zgjidhen nga 20 deputetë, kurse tre deputetë zgjidhen sipas modelit të shumicës dhe atë nga një deputet nga tre njësitë zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Australia dhe Azi. Që nga dita e verifikimit të mandatit deri në pushimin e tij deputetët gëzojnë imunitet (Ligji për Kuvendin, neni 53).

Deputetët zgjidhen për një periudhë prej katër vjetësh, megjithatë mandati mund të përfundoj edhe para skadimit atëherë kur: deputeti dorëhiqet, i pushon shtetësia, ndodh rasti i papërputhshmërisë me funksionin e deputetit, me aktvendim të plotfuqishëm privohet nga aftësia për punë, me aktgjykim dënohet për vepër penale me dënim burg në kohëzgjatje së paku pesë vjet (Ligji për Kuvendin, neni 6).

Deputetët organizohen në grupe të deputetëve (së paku pesë deputetë) të cilët i takojnë një partie politike ose më tepër partive politike (Rregullorja, neni 33). Nga rradhët e deputetëve zgjidhet Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit, numri i të cilëve caktohet në Kuvend me propozim të Kryetarit të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kryetari i Kuvendit e përfaqëson Kuvendin dhe kryen detyra të caktuara me Rregulloren e punës. Në realizimin e detyrave ndihmojnë edhe nënkryetarët të cilët zgjidhen nga rradhët

e deputetëve dhe u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqesuara në Kuvend, kurse njëri nga ta duhet të jetë nga partia më e madhe opozitare (Rregullorja e punës, neni 21).

Kuvendi ka edhe Sekretar të Përgjithshëm, të cilin e emëron Kuvendi me propozim të Komisionit për Cështjet e Zgjedhjeve dhe emërimeve. Sekretari i përgjithshëm kryen punë që ia beson Kryetari i Kuvendit (Rregullorja e punës, neni 64).

Sipas Kushtetutës, Kuvendi ka këto kompetenca: *“nxjerr dhe ndryshon Kushtetutën, nxjerr dhe bën interpretimin autentik të ligjeve; përcakton detyrimet publike; nxjerr Buxhetit dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit; nxjerr planin hapësinor të Republikës; ratifikon marrëveshje ndërkombëtare; vendos për luftë dhe paqe; merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës; merr vendim për aderim dhe dalje nga aleanca ose bashkësia me shtetet e tjera; shpall referendum; zgjedh Qeverinë; zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese; bën zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit; dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë”* (neni 68).

### 3. RAPORTI MES PUSHTETIT LIGJVËNËS DHE EKZEKUTIV

Në përgjithësi themi që Kuvendi kryen tre funksione kryesore: atë të përfaqësimit, legjislativit dhe kontrollit. Kuvendi është vendi ku buron sovraniteti i popullit, është tempulli i demokracisë, është organi që përfaqëson qytetarët (Bajrami & Mucaj, 2018: 337).

Padyshim, funksioni më i rëndësishëm është miratimi dhe ndryshimi i Kushtetutës dhe ligjeve. Megjithatë, sa i takon miratimit të ligjeve Kuvendi nuk ka ndonjë pushtet absolut. Pushteti vjen në shprehje me rastin e votimit të ligjeve. Pjesën më të madhe të ligjeve e propozojnë anëtarët e Qeverisë, deputetët ose qytetarët (së paku 10000 votues) (Kushtetuta, neni 71). Aktet juridike që miratohen në Kuvend i nënshkruan Kryetari i Kuvendit dhe ia përcjell Presidenti për nënshkrim të dekretit për shpalljen e ligjit. Disponimi me të drejtën e vetos i mundëson Presidentit ndikim të tërthortë në ligjvënien, Presidenti ka të drejtë të mos nënshkruaj një ligj nëse sipas bindjes së tij është në kundërshtim me Kushtetutën ose është i dëmshëm për shtetin. Në këto raste ligji kthehet në rishqyrtim në Kuvend. Gjithsesi, vetoja e Presidentit zhbëhet nëqoftëse ligji në fjalë sërish votohet me shumicë absolute. Presidenti ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin, në qoftë se sipas Kushtetutës, ligji nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (Kushtetuta, neni 75).

Funksioni i dytë i rëndësishëm i Kuvendit është kontrolli politik. Kuvendi ushtron kontroll politik ndaj Presidentit, me çrast në rast dyshimi për keqpërdorim të postit apo shkelje të Kushtetutës/ligjeve pozitive, mund t'i ndërpritet mandati, gjithsesi fjalën e fundit e ka Gjykata Kushtetuese. Kuvendi ushtron kontroll politik edhe ndaj Qeverisë dhe ka mundësinë e rrëzimit të saj (Rregullorja, neni 109-113). Këtu vlen të përmenden: komisioni anketues parlamentar, pyetjet e deputetëve, interpelanca dhe votëbesimi ndaj qeverisë.

-Komisioni anketues mund të shërbej si bazë për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë eventuale të bartësit të ndonjë funksioni publik. Komisioni anketues formohet me kërkesë të së paku 20 deputetëve dhe ka për obligim të analizoj ndonjë ndodhi ose rast konkret, të shqyrtoj dokumentacionin e duhur, të përgatis një raport të shkruar në lidhje me rastin konkret dhe ta prezantoj atë para Kuvendit.

-Pyetja e deputetëve është një e drejtë standard e deputetëve. Deputetët pyesin gojarisht ose me shkrim. Pyetjet ia dedikojnë Kryeministrit, ministrave ose bartësve të tjerë të funksioneve publike që i zgjedh ose emëron Kuvendi si psh: Prokurori Publik, Avokati i Popullit etj. Pyetjet e deputetëve kanë karakter të një publiciteti sepse pas parashtrimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve nuk hapet asnjë debat (Aziri, 2012: 234-238).

-Interpelanca paraqet mekanizëm kontrollues për punën e bartësve të funksioneve publike. Interpelanca ka të bëjë me punën e qeverisë, një pjesë të saj ose me punën e organeve shtetërore. Iniciativë për interpelancë mund të marrin së paku 5 deputetë (Kushtetuta, neni 72). Deputetët që ndërmarrin një aktivitet të tillë zakonisht i takojnë opozitës. Interpelanca dorëzohet në formë të shkruar. Organi ndaj të cilit hapet interpelanca duhet të përgjigjet gjithashtu me shkrim brenda një afati prej 15 ditësh. Për dallim nga pyetjet e deputetëve me rastin e interpelancës edhe pse jepet përgjigje me shkrim, përsëri hapet debat pas të cilit votohet.

-Votimi i mosbesimit ndaj qeverisë teorikisht është mjeti më serioz kontrollues i Qeverisë nga Kuvendi. Cështjen e votëbesimit mund ta iniciojnë së paku 20 deputetë. Që të jep qeveria dorëheqje pro duhet të votojnë së paku shumica e përbërjes parlamentare.

### 4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Shkalla e funksionalitetit të sistemit politik varret nga raportet që krijohen mes institucioneve, organeve dhe gjithë aktorëve që e bëjnë sistemin politik.

Kushtetuta e RMV-së, Kuvendin e parasheh si një institucion të pavarrur, të fuqishëm, me pozitë dominante ndaj pushtetit ekzekutiv. Këtë e dëshmon fakti që të drejtën e shpërndarjes së Kuvendit nuk e gëzon as Qeveria e as

Presidenti i vendit. Mandati i përbërjes parlamentare nuk varret nga Qeveria, në anën tjetër mandati i Qeverisë dhe i Presidentit varret nga Kuvendi.

Duke pasur parasysh rolin e fuqishëm të Kuvendit sugjerojmë përforcimin e rolit të tij, si vend ku diskutohet, debatohet dhe vendoset për interesa të përgjithshme.

#### LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Aziri, E. (2015). *Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore*, Tetovë.

Aziri, E. (2012). *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, UEJL, Tetovë, fq. 234-234.

Bajrami, F. & Mucaj, F. (2018), *E drejta kushtetuese*, Prishtine, fq.337-, fq. 381-409, fq. 411-415.

Kuculovska, R. & Sotiroska, V. & Grnçarevski, V. (2022), Shkup, *E drejta dhe rregullimi shtetëror*, fq. 52-57, e disponueshme online <https://w.w.w.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf>

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut me amendamentet e Kushtetutës I-XXX e disponueshme në : <https://w.w.w.sobranie.mk>, 2023

Kodi Zgjedhor, “Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11. Oline i disponueshem ne <https://w.w.w.sobranie.mk>, 2023

Neziri, L (2022) *The necessity to change the Macedonian electoral system for parliamentary elections*, në “International Dialogue: East-West” Vol.9 fq.17-21, e disponueshme online në:[https://konferencii.msu.edu.mk/ep-content/uploads/000-Pravo-i-Politikologija-2022\\_book-FINAL.pdf](https://konferencii.msu.edu.mk/ep-content/uploads/000-Pravo-i-Politikologija-2022_book-FINAL.pdf)

Neziri, L (2021), *Analysis of the electoral system for presidential elections in the Republic of North Macedonia: advantages and disadvantages*, ne Knowlegde- International Journal, Vol 51.1, fq. 251-256, e disponueshme online në.<https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/5061/5038>.

Ligji për partitë politike, “Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr. 07-4227/1, 2004.

Ligji për Kuvendin e disponueshme <https://w.w.w.sobranie.mk/>, 2023

Ligji për deputetët, “Gazeta Zyrtare e RMV-së”,nr 84/2005, 161/2008,51/11,109/14,140/18 e disponueshme <https://w.w.w.sobranie.mk/>

Rregulloja e punës së Kuvendit të RMV-së, 2008 e disponueshme <https://w.w.w.sobranie.mk/>